



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 5, datë 06.02.2024

**PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 1, BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 62, DATË 17.03.2023 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA”, PALLATIN NR.120 , I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR.**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit” i ndryshuar me Urdhërin nr.222, datë 06.07.2020, Raportit me nr. 995/1 prot., datë 26.01.2024 të Komisionit të Posaçëm si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e një shtese në Aneksin 1, bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 62, datë 17.03.2023, i ndryshuar, përsa i përket listës së përfituesve për pallatin nr.120, rruga “Aleksandër Goga”, në Njësinë Administrative nr.4, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, si më poshtë vijon:


Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT, QË DO PËRFITOHET
11	MAHMUDE DOMI	5	3+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 07.02.2024**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 97/5 prot.

Durrës, më 15 02 .2024

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.5 datë 06.02.2024 “Për miratimin e një shtese në aneksin nr 1, bashkalidhur VKB Nr 62 dt 17.03.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr 4, Rruga A.Goga, Pallati nr 120, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019, i ndryshuar”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

